



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Janar 2022

Nr: 18

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, Z. RAMAZAN HALIT BUCI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 47099 prot., datë 25.11.2021, këshilli i bashkisë Tiranë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Bardhylka Vangjel Kospiri, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 66, z. Ramazan Halit Buci.

Me shkresën nr. 7065, prot, datë 03.12.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatis për anëtar në këshillin e bashkisë Tiranë, z. Ramazan Halit Buci, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Data: 26 Janar 2022

Nr. 18

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Ramazan Halit Buci

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar dhe depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2200 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, z. Ramazan Halit Buci, në këshillin e bashkisë Tiranë, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 7131 prot., datë 14.12.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 7130 prot., datë 14.12.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Ramazan Halit Buci, në këshillin e bashkisë Tiranë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Tiranë, z. Ramazan Halit Buci.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.13362/1 prot., datë 17.12.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Ramazan Halit Buci, në këshillin e bashkisë Tiranë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar z. Ramazan Halit Buci, në këshillin e bashkisë Tiranë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



V E N D O S:

1. Z. Ramazan Halit Buci, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Ramazan Halit Buci.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 26 Janar 2022

Nr. 18

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Ramazan Halit Buci